



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 22.01.2024

Projekt-Vendim - NR. 4

PËR

“SHLYERJE DETYRIMI PËR EKSPERT-PSIKOLOG VENDOSUR NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KORÇE MBI RASTIN E FËMIJËS F. MYRTOLLARI”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 121/2026 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, neni 55, 57, 59, ne Kodin e Familjes neni 267, 271, dhe udhëzimit 4 datë 12.12.2021, ndryshuar me udhëzimin nr 1, datë 6.03.20219 mbi “Përcaktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”, kreu II pika 2, si dhe në Planin Individual të Mbrojtjes për fëmijën F.Myrtollari, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq të miratojë :

I. Shlyerjen e detyrimit për ekspert-psikolog vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë mbi rastin e fëmijës F. Myrtollari në seancën gjyqësore të datës 04.10.2023, psikologe Marinela Postoli (Eksperte psikologe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë), në masën 40 000 lekë.

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2024, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarisë	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	40 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacioni shpjegues mbi rastin

IV. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.

Konceptoi: N.J.M.F
Pranoi: Përgj. Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
Jurist:

(EmërMbiemër)
B.Avdolli
E.Petriti
N.Caushi

Nënshkrimi

Data
Dt.22.01.2024
Dt.22.01.2024
Dt.22.01.2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 22.01.2024

RELACION
PËR
“SHLYERJE DETYRIMI PËR EKSPERT-PSIKOLOG VENDOSUR NGA GJYKATA E
RRETHIT GJYQËSOR KORÇË MBI RASTIN E FËMIJËS F. MYRTOLLARI”

I mituri F.Myrtollari i datëlindjes 24.10.2022, i biri i zotit Zarif dhe zonjës Matilda Myrtollari aktualisht është i strehuar IPSH Tiranë, bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë Nr.Regj.Them.23000-00245-41-2023(903) datë 24.02.2023 me kërkesë nga Bashkia Maliq, për marrjen e masës së mbrojtjes “Vendosje në perkujdesje alternative të femijës”. Bazuar në ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, neni 55, 57, 59, në Kodin e Familjes neni 267, 271 si dhe në Planin Individual të Mbrojtjes për fëmijen F.Myrtollari. Gjatë seancave gjyqësore është parë e nevojshme përcaktimi i një eksperte psikologe së cilës i janë përcaktuar disa detyra, një ndër të cilat është edhe vlerësimi i lidhjeve emocionale që ekzistojnë ndërmjet fëmijës së mitur dhe prindërve biologjikë, si edhe të bëjë vlerësimet përkatëse në bazë të moshës dhe zhvillimit të fëmijës. Për ekspertimin nga eksperti i licensuar, Marinela Postoli, pala kërkuese Bashkia Maliq duhet të bëjë pagesën për detyrën e ngarkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Konceptoi: N.J.M.F
Pranoi: Përgj. Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror
Jurist:

(EmërMbiemër)
B.Avdolli
E.Petriti
N.Caushi

Nënshkrimi

Data
Dt.22.01.2024
Dt.22.01.2024
Dt.22.01.2024

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu